

BASHKI TË FORTA - FORCIMI I ROLIT TË SEKRETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK

Konteksti

Helvetas Swiss Intercooperation i është dhënë mandati nga SDC për të zbatuar programin "Bashki të Forta" (BF) në Shqipëri. Pas një reforme administrative-territoriale dhe një procesi decentralizimi që nënkupton për bashkitë territore më të mëdha për tu administruar dhe funksione të shtuara, projekti mbështet bashkitë për të përmirësuar shërbimet publike duke siguruar një menaxhim të orientuar nga qytetarët. Asistenca teknike për administratat është e kombinuar me mbështetje për pjesëmarrje nga poshtë-lart dhe monitorim përmes këshillave bashkiak. Projekti gjithashtu forcon kapacitetet e agjencive të përqendruara në nivel rajonal në mënyrë që ato të kontribuojnë në zbatimin e politikës së decentralizimit të qeverisë qendrore.

Objektivat e projektit

Qëllimi kryesor i projektit është të përmirësojë shërbimet publike, duke mbështetur administratat bashkiake, këshillat bashkiak dhe qytetarët të angazhuar për të kontribuar në ofrimin e shërbimeve më të mira. Një nga objektivat e tij specifik është forcimi i funksionit përfaqësues dhe mbikëqyrjes i Këshillave bashkiak. Gjithashtu, funksioni i sekretarit është identifikuar si rol kyç që mbështet një funksionim më të mirë të këshillave vendor. Pritet që BtF t'i forcojë ato duke zhvilluar udhëzime dhe manuale për forcimin institucional të sekretarit të këshillit, si dhe të përmirësojë modelin ekzistues për një funksionim më të mirë.

URI në rolin e konsulentit të BtF, ka analizuar rolin e sekretarit në ndërmjetësimin këshill-ekzekutiv-komunitet, në 6 bashki, duke propozuar përmirësime konkrete. Gjithashtu, ka siguruar një përmbledhje të gjetjeve kryesore të funksioneve aktuale, rolit dhe mënyrat e punës së sekretarit të këshillit, gjetjet e

raportit, problemet dhe praktikave më të mira të lidhura me veprimtarinë e sekretarit të këshillit. Ka propozuar Terma Reference (TR) për funksionin ekzistues të sekretarit të këshillit dhe një plan për ngritjen e kapaciteteve bazuar në analiza dhe praktika të mira që synojnë përmirësime afatshkurtra, menjëherë pas zgjedhjeve vendore. Ka propozuar ndryshime afatshkurtra organizative dhe instrumente financimi (modele tip) mbi të cilat BtF mund të advokoi në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesëm, në mënyrë që të përmirësojë funksionin përfaqësues dhe mbikëqyrës të këshillit.



Rezultatet e Projektit

- Raport narrativ i gjetjeve: raportimi i gjetjeve, problematikave dhe boshllëqeve në lidhje me rolin aktual, funksionet dhe modelet e punës së sekretarit të këshillit; modeli i propozuar në afat të shkurtër dhe afatmesëm (forma strukturore dhe rregullatore, si dhe instrumentet e financimit); propozimi i temave të trajnimit dhe planit të ngritjes së kapaciteteve (përfshirë Rregulloren e Sekretarit), si dhe mundësimin e bazës ligjore / të politikave ose rekomandime për përmirësime.
- Raport narrativ për sekretarin e Këshillit Bashkiak dhe analiza krahasuese midis modelit të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit.
- Përcaktimi i temave të trajnimit dhe TR për të zhvilluar module trajnimi bazuar në planin e identifikuar të ngritjes së kapaciteteve.

- Zhvillimi i praktikave të mira që i referohen drejtpërdrejt funksionit të sekretarit në raport me qytetarët, komisionet, agjencitë e dekoncentruara, prefekurat, ekzekutivin etj.
- Propozimi i kuadrit ligjor bazë në rregullimin e punës së funksionit të sekretarit dhe statusin e zbatimit të tij.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

- Helvetas Swiss Intercooperation (HSI)/SDC

PËRFITUES:

- Bashkitë Berat, Divjaka, Kukës, Vlorë, Vorë dhe Kamëz

KOHËZGJATJA:

- 01/2019 - 05/2019

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.